Kronikë

Shkodër/ Me armë me vete në makinë, pranga 40-vjeçarit! Nis hetimi për të miturin

Gjatë operacionit, në lagjen "Liria", blutë ndaluan automjetin me të cilin qarkullonin 40-vjeçari dhe një i mitur.

Foto ilustruese

Redaksia
26 Nëntor, 14:16 | **Përditësimi: 26 Nëntor, 14:22**

Share

Policia e Shkodrës ka finalizuar operacionin e koduar "Blic" në kuadër të të cilit ka vënë në pranga një 40-vjeçar, ndërsa ka nisur hetimet për një të mitur.

Blutë ndaluan automjetin me të cilin qarkullonin 40-vjeçari dhe adoleshenri në lagjen "Liria".

Gjatë kontrollit fizik, të miturit iu gjet një sasi lënde e dyshuar narkotike kanabis, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

LEXO EDHE:
Paketa e Maleve/ Qeveria miraton zonat prioritare për zhvillim në Shijak, Mat dhe Shkodër

Njoftimi i policisë:

Në zbatim të planit të masave për rritjen e parametrave të sigurisë, duke evidentuar dhe goditur veprimtaritë kriminale, bazuar edhe në informacionet e siguruara në rrugë informative, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" kanë organizuar dhe finalizuar operacionin e koduar "Blic".

Gjatë operacionit, në lagjen "Liria", shërbimet e Policisë lokalizuan dhe ndaluan automjetin me të cilin qarkullonin shtetasi M. K. dhe një 16-vjeçar. Gjatë kontrollit fizik, 16-vjeçarit iu gjet një sasi lënde e dyshuar narkotike kanabis, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit M. K. u gjet 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve procedurale, specialistët për Hetimin e Narkotikëve:

-arrestuan në flagrancë shtetasin M. K., 40 vjeç, banues në fshatin Barbullush, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit";

-referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për 16-vjeçarin, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | armembajtje pa leje | kanabis

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
25 Nëntor, 12:21
Si po iu duken protestat e përjavshme të PD-së para Kryeministrisë?

Të duhura | Të dështuara | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

U kapën me 332 kg kanabis dhe kultivuan 32 mijë rrënjë narkotike në 2022, GJKKO gjykon grupin kriminal prej 22 personash në Malësi të Madhe, 2 të pafajshëm
26 Nëntor, 16:36

Dyshohet se do kryenin sulm, dy terroristët në Fushë Arrëz u ndihmuan nga një person i tretë! 'Kyçin' gojën: Gjykohemi nga Zoti
26 Nëntor, 10:46

Arrestimi i dy terroristëve në Fushë-Arrëz/ Gazetari: Kishin hapur grupë për të qëlluar policinë! Qirjazi: Të zhgënjyer nga besimi! Karanxha: Rast i izoluar
25 Nëntor, 22:33

Spahiu: Shqipëria fatmirësisht s'ka celula terroriste të huaja, ndryshe nga BE
25 Nëntor, 21:40

Vrasja e Fatbardh Licit, SPAK dërgon për gjykim Safet Bajrin, Behar Bajrin, Astmer Bilalin dhe Eria Agon
25 Nëntor, 20:14

I rezistoi 12 orë RENEA-s, Hamza Uka me histori të gjatë radikalizmi! Flet prokurori që e hetoi në 2019-n: Na kërcënoi në sallën e gjyqit! Zero bindje ligjeve

Sokol Dema

25 Nëntor, 16:19

I shpallur në kërkim për prodhim të narkotikëve, arrestohet 33-vjeçari në Muriqan! Gjykata e Durrësit i kishte caktuar masën arrest me burg
25 Nëntor, 15:31

Ekskluzive/ Report Tv në kullën e ngujimit të terroristëve në Fushë-Arrëz, dyshohet se po përgatisnin sulm! Nga tuneli i nëndheshëm te fortifikimi (VIDEO)

Armir Mehaj

25 Nëntor, 15:08

Lëvizte i armatosur me makinë, arrestohet 34-vjeçari në Kamëz (EMRI+VIDEO)
25 Nëntor, 10:42

U dorëzuan pas 12 orësh 'ngujim' në Fushë-Arrëz, policia jep detaje për arrestimin e dy të armatosurve: Qëlluan me armë drejt forcave RENEA
25 Nëntor, 09:11

12 orë rezistencë, Report Tv siguron fotot e arrestimit të dy të terroristëve në Fushë-Arrëz! Qëlluan drejt RENEA-s, u gjenden armë e flamuri i ISIS (VIDEO)
25 Nëntor, 08:57

Fushë-Arrëz/ 12 orë rezistencë në banesë, vetëdorëzohen 2 të armatosurit në Orosh! RENEA 'blindoi' fshatin, ishin në vëzhgim nga Antiterrori (VIDEO)

Armir Mehaj

24 Nëntor, 14:26

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet ripërdhimi i paautorizuar i kesaj faqeje